

KONTRATË SHITJE

Sot më datë 23/04/2024 palët pjesmarrëse kanë rënë dakort për lidhjen e kontratës së mëposhtme”

PALËT PJESMARRËSE NË KONTRATË :

- **Taulant Musabelliu**, shtetas shqiptar, me zotësi të plotë juridike për të vepruar dhe me numer personal identifikimi I01021087U , lindur më Skrapar, Shqipëri me adresë banimi Tiranë, Shqipëri (Shitesi)
- **Erind Aliçkolli** shtetas shqiptar, me zotësi të plotë juridike për të vepruar dhe me numer personal identifikimi I70402100U , lindur më Pogradec, Shqipëri me adresë banimi Tiranë, Shqipëri. (Blerësi)

Neni 1

OBJEKTI I KONTRATËS

Objekti i kësaj kontrate është shitja e kuotave zotëruese nga Taulant Musabelliu i cili përfaqësojnë 36.25% të kapitalit të shoqërisë “Tok Digital Agency me numër unik (NUIS) L62126009T, me adresë Tirane Tirane Rruga Abdyl Frasheri,EGT Tower, Kati 6, Hyrja 14, 1019 Tirane.

- Shitjen e kuotës zotëruese nga Taulant Musabelliu **36.25%** të kapitalit të shoqërisë, **Tok Digital Agency:** te Erind Aliçkolli 36.25% te kuotave.

Neni 2

Cmimi

Cmimi i shitjes së 1 (një) kuote e cila përfaqëson 36.25% të kapitali të shoqërisë “Tok Digital Agency” është 2 537 500 leke.

Neni 3

Afati i pagimit te cmimit

Pagimi i cmimit do të kryhet pas nënshkrimit të kësaj kontrate.

Neni 4

Të drejtat dhe detyrimet e shitesit



1. Shitësi ka të drejtë të kërkojë nga blerësi pagimin e cmimit ne mënyrën dhe afatin e parashikuar në këtë kontratë.
2. Shitësi është i detyruar t'i dorëzoje blerësit të gjithë dokumentacionit që shënon të drejtën e pronësisë dhe që janë të nevojshme për kalimin e saj.
3. Shitësi duhet te garantoje bleresin per gezimin e qetë te kuotave nga cdo e drejtë pronësie të personave të trete. Shitësi është i detyruar të marrë pjesë në gjykim në mbështetje të blerësit nese ai thirret prej tij, për ta garantuar ndaj pretimeve te personave te trete, mbi kuotat objekt i kontrates.

Neni 5

Te drejtat dhe detyrat e bleresit

1. Bleresi ka të drejtë te kërkojë dokumentat qe vërtetojnë pronësinë e shitësit mbi kuotat, objekt kontrate nga shitesi nga e nesermja e hyrjes ne fuqi të kësaj kontrate.
2. Bleresi eshte i detyruar të marrë në zotërim vendin ku shoqëria ka qendrën e ushtrimit të aktivitetit

Neni 6

Zgjidhja e kontratës

1. Shitesi ka të drejtë të kërkojë të zgjidhe kontraten kur:
 - a) blerësi nuk paguan cmimin.
 - b) blerësi nuk merr në dorëzim objektin ku shoqëria ushtron aktivitetin , brenda 15 ditëve nga afati shtesë i caktuar nga shitësi;
 - c) blerësi nuk merr në dorëzim dokumentat e pronësisë së kuotave
2. Bleresi ka të drejtë të kerkojë zgjidhjen e kontratës kur:
 - a) shitësi nuk dorëzon dokumentat e pronësisë së kuotave
 - b) shitësi nuk dorëzon objektin e ushtrimit të aktivitetit të shoqërisë, objekt kontrate brenda afatit shtese 10 ditor, te caktuar nga bleresi ;
 - b) shitesi deklaron brenda afatit 10 ditor se nuk do te dorezojë dokumentacioni dhe objektin e ushtrimit të aktivitetit

Neni 7



Pasojat e zgjidhjes se kontrates

1. Shitësi me zgjidhjen e kontratës duhet t'i kthejë pagesat e bëra blerësit, dhe gëzon të drejtën për shpërblimin e dëmit .

Neni 8

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Në rast mosmarrveshje midis tyre palët do t'i zgjidhin me mirëkuptim, dhe vetëm kur një gjë e tillë është e pamundur ato do t'i drejtohen gjykates se "Rrethit Gjyqësor Tiranë".

Neni 9

Shpenzimet per lidhjen e kontratës

Shpenzimet për lidhjen e kësaj kontrate i ngarkohen te dyja palëve përkatësisht.

Neni 10

Momenti i kalimit të pronësisë dhe Hyrja në fuqi

Kuotat zotëruese të ortakes Taulant Musabelliu shoqërinë "Tok Digital Agency "Shpk në datën 23/04/2024 kalojnë në pronësi të **Erind Aliçkolli** si më poshtë:

- Kuota zotëruese nga Taulant Musabelliu i cili përfaqëson 36.25% të kapitalit të shoqërisë i kalojnë Erind Aliçkolli me vlere 2 537 500 leke. Kjo kontratë hyn në fuqi në datën 23/04/2024 me nënshkrimin e kontrates ku Te dyja palet nuk kanë pretendime mbi cmimin dhe bien dakort që rregjistrimi te kryhet menjëherë.

Neni 11



Hartimi i kontratës

Kjo kontratë u hartua në **2 (dy)kopje** nga një për secilën palë.

PALËT KONTRAKTUESE

SHITËSIT :

Taulant Musabelliu

BLERESI :

Erind Aliçkolli